



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-55938

Dt. 13.05.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Valdet Çoçaj** nga **Prizreni** me banim në rrugën **"Qen Qenaj" p.n** në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe konform neneve 14,15,16,17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 , si dhe konform nenit 4 pika 6.1 ,paragrafi 2,dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoba nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.01/011-46063 dt.28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 me Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Valdet Çoçaj		
Adresa:	Rr.Qen Qenaj p.n-Prizren		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i projektit	Ndërtimi i objektit – Shtëpi individuale për banim
Emri i projektuesit	"DLA Studio Pz SH.P.K"
Adresa:	Rr.Brigada 125-Prizren

Telefoni:	//	Emaili:	
-----------	----	---------	--

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Valdet Çoçaj** i lejohet ndërtimi i objektit-**Shtëpi individuale për banim** në rrugën “ Vëllezërit Bytyçi” pn. me numer të ngastres **P-71813023-00615-40 Zk.Dushanovë**.

Për punët ndërtimore në vijim		
Adresa: Prizren		
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën ZB-1. Ndërtimi i objekti – Shtëpi individuale për banim- do të bëhet në parcelën nr. P-71813023-00615-40 Zk.Dushanovë me sipërfaqe S=1000 m² me dimensione sipas kopjes së planit. Etazhiteti i objektit do të jetë P+2 Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=150.0 m² . Sipërfaqja neto e përdhësës është S=129.24 m² . Sipërfaqja bruto e katit I është S=160.80 m² . Sipërfaqja neto e katit I është S=140.04 m² . Sipërfaqja bruto e katit II është S=160.80 m² . Sipërfaqja neto e katit II është S=140.04 m² . Sipërfaqja bruto e objektit është S=471.60 m² Siperfaqja neto e objektit është S=409.32 m² .	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndertimore në shumën prej **2,684.54 €**
- Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **146,161.50 €**.

Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtimi i ri ☒	Rindertim ☐ Riparim ☐
Kategoria e ndertimeve te propozuera:	
Kategoria I ☐ Kategoria II ☐	
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒	
Perdorimi i propozuar i objektit –Shtëpi individuale	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Valdet Çoçaj** i lejohet ndërtimi i objektit -**Shtëpi individuale për banim me etazhitet P+2.**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
 - Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
 - Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuar nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriat i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga koprojektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rast kur:

- Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.
 - Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve ndërtimore si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori.
- P.S. Investitori është i obliguar të bëjë mbrojtjen dhe sigurinë në punishte dhe është përgjegjës dhe obligohet që gjitha dëmtimet e mundshme të rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit, PTK, KEDS-it, dhe avari tjera ti evitojë dhe ti kthejë në gjendje të mëparshme me shpenzimet të veta dhe pa të drejtë kompensimi.
- Investitori është përgjegjës dhe obligohet që problemet eventuale që paraqiten në lidhje me qasje në rrugë të evitojë vetë investitori.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Valdet Çoçaj** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit **–Shtëpi individuale për banim.**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:


- Njoftim për plotësim të dokumentacionit 04-353/01-14571, Dt. 27.02.2024
- Pëlqimi nga "KEDS-i".
- Pëlqimi nga Kom."Hidroregjioni Jugor".
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Pëlqimi nga KRU "Dukagjini-Radoniqi" Sh.A.Gjakove.
- Vertetim nga sektori i menaxhimit të mbeturinave nga DSHP
- Katër kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet MMPHI-së, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR


Nr.04-351/02-55938, dt.13.05.2024

Bashkëpunetor profesional:


Afërdita Mormorina, inxh.dip.ark.


Gazmend Berisha, Msc.ndërt.

DREJTORI:


Pranverim Berisha, jur.